

EUROPA

DREJTOR: ALBERT RAKIPI • KRYEREDAKTOR: MARSIDA GJONÇAJ • SHEFE E MARREDHENIEVE ME JAShte: ADELA HALO

Presidenca Suedezeze merr kryesimin e BE



Presidenca Suedezeze nisi detyrën e saj të kryesimit të BE-së. Që nga 1 Korriku deri në fund të këtij viti do të jetë Suedia ajo që do të çojë përpara punën në BE. "Këto 6 muaj do të jenë plot gjallëri, por detyra që na del përpara nuk është e thjeshtë. Po pres të merrem edhe me çështje të tjera që vijnë në vjeshtë," thotë kryeministri Suedez Fredrik Reinfeldt. "Ajo çka është më e rëndësishme është të jemi në gjendje që të reagojmë të gjithë tok ndaj sfidave apo kërkesave që kanë njerëzit dhe të shohim se ku mund të bëhet ndonjë ndryshim. Fjala është për krizën ekonomike që shkon paralel edhe me rritjen e papunësisë që për fat të keq po ndikon në gjithë Europën. Na del si detyrë t'i vëmë njerëzit në lëvizje të mëtejshme për çështjen e ndryshimit klimaterik. Këto janë prioritetet që do të dominojnë presidencën tonë", shton Fredrik Reinfeldt.

Programi i Stokholmit

Por ka edhe çështje të tjera me rëndësi me të cilat presidenca suedeze ka caktuar të merret gjatë kryesisë së saj. Një prej tyre është zhvillimi dhe forcimi i bashkëpunimit të BE-së në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme në Programin e Stokholmit, me qëllim që të jetë në pozitë më të mirë për të luftuar krimin e organizuar. Një tjetër detyrë është miratimi i një strategjie të BE-së për rajonin e detit Baltik, me qëllim që të merret me problemet ambientaliste dhe të rrisë aftësinë konkurruese të zonës, së bashku me vazhdimin e punës për krijimin e lidhjeve të ngushta mes BE-së dhe vendeve fqinje të saj. Presidenca Suedezeze do të punojë gjithashtu për forcimin e rolit të BE-së si aktor global me synim të qartë paqen, zhvillimin, demokracinë dhe të drejtat njerëzore. "Përveç kësaj, duhet të presim të papriturën. Të përballlemi me ngjarje të...

FAQE 3

Në këtë numër:

BE përsërit mbështetjen për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor

FAQE 8

NATO Listë e Bardhë, Shengen Listë e Zezë

FAQE 10

"Si i ka përmbushur Republika Çeke objektivat politike?"

FAQE 12

Përfundon Samiti i Kroacisë - 2009

FAQE 6

ME MBESHTETJEN E FONDACIONIT SHOQERIA E HAPUR PER SHQIPERINE (FONDACIONI SOROS, OSFA)



AIIS